


VITI XVI, NUMRI 8 / GUSHT 2012

FOREVER



HENGARI | ALBANIA | BOSNIA A D HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



FOREVER 

SUPER RALLY
PHOENIX

16-18. 08. 2012



TË MËSOJMË VAZHDIMISHT

Jemi në Gusht, dhe kjo për Foreverin do të thotë vetëm një gjë. Po tamam, është koha e takimit Super Rally! Vërtet kaluan 12 muaj që nga koha kur qemë mbledhur bashkë në Hotelin Gaylord në Washington? Është vështirë ta matësh sa shpejt mund të iki një vit. Duke festuar së bashku Super Rally-n, unë për një moment qëndroj dhe reflektoj për ato kohë të mrekullueshme që kemi kaluar së bashku në vite, në Super Rally-t e zhvilluar në disa qytete të SHBA, por edhe në disa vende të tjera jashtë SHBA. Të kesh të mbledhur bashkë për disa ditë, disa mijra distributorë që punojnë fort kudo nëpër botë, është diçka që unë e pres me kënaqësi. Është gjë e veçantë të takosh përsëri miqtë e vjetër por edhe të bësh miq të rinj.

Në çdo rast, që të kualifikohesh për Rally nuk është gjë e lehtë. Së pari është vecanrisht e vështirë, sepse ju e filloni nga zeroja dhe duhen nja dy vjetë për të ndërtuar një biznes që arrin një nivel xhiroje me 1500 CC.

Por të kualifikohesh për Rally është vërtet një matje e suksesit tuaj. Ai

është një gur kilometrik që ju tregon juve dhe gjithë botës Forever, se ju jeni serioz në këtë biznes dhe ju nuk e njihni dështimin. Nuk flas shpesh për dështimin, por dua të ndaj me ju një histori që kam dëgjuar kohët e fundit. Disa vite më parë ishin tre vetë në biznesin e muzikës – njeri ishte këngëtar i njohur në shkallë ndërkombtare, i dyti ishte një menaxher i talentuar dhe i treti një këngëtar i ri premtues. Më kujtohen akoma disqet e të dy këngëtarëve – ata ishin jashtëzakonisht të talentuar.

Menaxheri bëri diçka që është shumë e zakonshme në atë industri dhe që zakonisht është fitimprurëse për të dy palët. Ai e nisi këngëtarin e ri në një turne me superstarin. Menaxheri shpresonte që këngëtarin e ri do të mësonte nga këngëtarin më me përvojë dhe duke vepruar kështu do të bënte çka ishte e nevojshme për një sukses afatgjatë.

Për fat të keq nuk ndodhi ashtu.

Këngëtarin e ri kishte kryesuar listën e hiteve pesë herë. Dhe vërtet kishte talent, por këto suksese të fillimit kishin që rezultat i asaj që para publikut kishte dalë bashkë me superstarin. Por për fat të keq i nuk e kishte kuptuar këtë gjë. Duke parë këtë sukses ai mendoi se nuk kishte për të mësuar më nga superstarin. Ai nuk donte të ishte më si premierë e dikujt. Ai tani mendonte se kishte ecur shumë përpara. Kështu ai u shkëput nga menaxheri i tij. Por për habinë e askujt përveç habitës të tij, këngëtarin e ri, tepër i talentuar u avullua nga skena e muzikës popullore. Ai nuk prodhoi më disqe hit.

Në një farë kuptimi kjo është vërtet një histori tronditëse sepse këngëtarin e ri ishte vërtet i talentuar. Por nga mënyrat e tjera ai nuk ishte i talentuar. Për fat të keq këtë gjë e kam parë shumë herë edhe në biznesin tonë, qofshin këta distributorë të rinj që mendojnë se nuk kanë nevojë për mësimet që u ka mësuar koha sponsorve të tyre, apo edhe distributorë më të vjetër që mendojnë se sistemet MLM të dala kohët e fundit kanë mundësi më të mëdha për tu pasuruar.

Ne të gjithë e dimë se çfarë ndodh zakonisht kur njerzit braktisin mësimet dhe metodat që i kanë çuar ata në sukses: ata provojnë dështimin. Gjëja më e çuditshme është se ata nuk presin që të dështojnë, prandaj dhe ua tregoj këtë histori. Unë nuk dua që askush nga ne të harrojë se nuk ka më nevojë për të mësuar. Gjithmonë ka gjëra për të mësuar dhe ne duhet të kërkojmë ti mësojmë ato. Unë jamë në këtë biznes prej 35 vjetësh dhe më vjen mirë që kam mësuar ca gjëra. Por unë jam gjithnjë e më i vendosur që të jem i rrethuar nga njerëz të mrekullueshëm, nga distributorë të mëdhenj, nga miq, nga njerëz të komunitetit, nga njerëz të bizneseve të bukura, pra nga çdo kush që ka provuar suksesin në një fushë ku edhe unë dua të jem i sukseshëm.

Le të mos e harrojmë këtë histori për sa kohë duam të krijojmë një jetë më të mirë për vete dhe për familjen. Ne nuk jemi plotësisht të ditur dhe nuk do të jemi kurrë. Ka mjaftë gjëra për të zbuluar dhe mjaftë njohuri për ti bërë për vete dhe për ti zbatuar ato në jetë. Në Forever ka shumë njerëz të ndritur nga të cilët mund të mësojmë. Duke marrë pjesë në Super Rally-n e këtij viti, unë shpresoj se ju do të jeni bashkë me miqtë e vjetër me të cilët ju keni ndarë hallet dhe keni mësuar kaq shumë, dhe shpresoj gjithashtu të gjeni rastin të njiheni atje edhe me njerëz të rinj nga të cilët mund të mësoni vazhdimisht. Foreveri është një biznes se si të ndajmë fitimin së bashku, si të mësojmë dhe të kemi sukses së bashku. Ejani në takimin Rally të gatshëm dhe të etur për të mësuar, dhe unë ju garantoj se do të arrini suksesin që dëshironi.

Mirëupafshim në Phoenix.

REX MAUGHAN

I JUJ PËR GJITHMONË



PROGRAMI GJITHËPËRFSHIRËS I RUAJTJES TË SHËNDETIT NË HUNGARI

Edhe këtë vit vazhdon programi më i madh i kontrollit të përgjithshëm mjekësor dhe me kënaqsi ju bëj të ditur se Forever Living Products Hungari, ndërmjet firmave të marketingut multilevel (MLM) është e para dhe e vetmja që është përfshirë në këtë program. Ky program na jep mundësi të mëdha që ti prezantohemi vendit dhe në çdo takim për çështjet e shëndetsisë të organizuar në kuadrin e këtij programi të arrijë të jetë nga firmat më të mëdha dhe deri në vitin 2020, popullsia jonë prej rreth 10 milionësh ta njohë drejt për së drejti veprimtarinë e Forever Living. Falnderojmë organizatorët për mundësinë e pjesëmarrjes dhe për nivelin e lartë profesional, që përfaqsojnë në fushën e shëndetit.

Për shkak të keqësimit që vrehet në gjëndjen shëndetsore të popullsisë me ndihmën e kontrollit të përgjithshëm mjekësor, duhet vënë theksi tek parandalimi i sëmundjeve, domethënë tek ndryshimi i mënyrës të të jetuarit si dhe tek pakësimi i faktorëve që dëmtojnë shëndetin. Filozofia e Forever Living Products në themel ka shëndetin dhe sigurinë materiale, kështu është një nder i madh për ne, që firmat që merren me tregëtimin e plotësuesve dietikë në Hungari, në këto takime ti përfaqsojmë ne. Me çfarë do të kontribuojë Foreveri në këtë program? Në radhë të parë me produktet fantastike, me Aloe Vera. Është një kënaqsi e veçantë për ne që organi i specializuar për këtë program, në mënyrë ekskluzive pranoi dhe zgjodhi produktet e shkëlqyera të mëposhtëme: Forever Ginkgo Plus, që ndihmon kur kemi furnizimin e pamjaftueshëm të trurit me gjak, për përmirësimin e kujtesës të dobësuar nga mosha apo edhe të rënies të aftësisë mendore si dhe preparatin tonë ARG1+ , i dobishëm veçanrisht për sportistët.


Me zemër të qetë mund të them se të paktën ky specialitet që Foreveri përfaqson në këto takime që është kaq i rëndësishëm sa do ti trasmetojnë publikut të gjërë njohuritë e tyre, mjekë, farmacistë, punonjës shëndetsie, mjekë alternativë të shkëlqyer e të vlerësuar nga organet shtetërore e shoqërore dhe natyrisht edhe lektorët më të mirë të këtij profesioni. Trasmetimi i përvojës tonë 15 vjeçare ka vërtet rëndësi për jetën tonë. Ka rëndësi që këto njohuri të mëdha të mund ti ndajmë edhe me të tjerët. Ky program na jep një mundësi të shkëlqyer, që Foreverin ta popullarizojmë në vendin tonë dhe kushdo të mund të njohë produktet tona sensacionale dhe të bashkohet në Skuadrën gjithnjë në rritje të Foreverit.


Ky program në Hungari funksionon. Në qoftë se edhe ju në vendet tuaja, gjeni një nismë të tillë, ju lutem mos kini frikë të dhni hapin e parë dhe ne do tu ndihmojmë!

Çdo pjesëmarrësi, çdo lektori i uroj shumë sukses dhe rezultate të shkëlqyera! Falënderoj në mënyrë të veçantë grupin tim të marketingut për punën me nivel jashtëzakonisht të lartë të bërë për fillimin e programit!

Përpara FLP!




DR. SÁNDOR MILECZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM




Success Day

BUDAPEST 21 KORRIK 2012



Ditën e fundit të Suksesit të kësaj vere, FLP e Hungarisë e organizoi në Qendrën Syma. Me këtë rast minutat e para u dhurohen atyre , për të cilët jemi më krenarë, për bashkpunëtorët që kanë arritur në nivelet më të larta të distributorëve – me parakalimin e tyre në skenë fillon kjo ditë.

Drejtuesit e programit u prezantojnë pjesëmarrësve mundësinë Forever, sepse i njohin me saktësi avantazhet e ndërtimit të biznesit MLM kundrejt qënies i punësuar apo sipërmarrës. Senior menaxherët **Ádám Nagy dhe Brigitta Belényi** ndërruan vëndet e tyre të punës që paguheshin mirë për një jetë të re. Që nga ajo kohë 3 herë kanë realizuar programin Profit Sharing, janë anëtarë të Klubit të Presidentit, dhe sipas objektivit të tyre së shpejti do të kualifikohen soaring menaxherë. Ata që veprojnë në FLP, takimin mujor të Ditës së Suksesit e hapin me një ide të rëndësishme: „ky biznes e forcon familjen dhe nuk e ndan”. Pas kësaj thërrasin në skenë njeriun e një familje të madhe, drejtorin e përgjithshëm **Dr Sándor Miliesz**- zafir menaxher.





– Kush do të vijë në Phoenix- pyet Dr Sándor Milesz, duke patur parasysh Super Rally-n, ndërkombtar të Foreverit, që në këtë formë do të jetë i fundit. – „Do të jetë gjë e bukur, shumë e bukur” – shprehet drejtori, pastaj thekson “por duhet punuar, ndryshe rezultatet nuk vijnë vetë”.

FLP – si e vetme në serinë e firmave MLM, merr pjesë në projektin e mbështetur nga Bashkimi Europian „Programi i kontrollit mjekësor për ruajtjen e shëndetit në Hungari për periudhën 2010-2020”. Përhapja e dijeve për ruajtjen e shëndetit është detyra jonë, që me këto të rriten fëmijët, kjo është e ardhmja” – thotë Dr Sándor Milesz, pastaj kërkon që fëmijët të ngrënë dorën lart. Pak lëvizin por ai mendonte për më shumë njerëz, mbasi sikurse thotë ai: të gjithë jemi fëmijë: pasardhës të prindërve tanë. – „Punoni për fëmijët, punoni për veten që të krijojmë vërtet diçka të madhe në Hungari! Të konsumojmë nga këto produkte, ajo i zjell pikët. Karta Forever dhe shpërblimet e tjera janë vetëm qershia mbi tortë, ajo që të tregon se je në vend të mirë”! Le të jemi fëmijët më të mirë të **Rex Maughan!**”

Dita e Suksesit në Budapest gjithmonë fillon me leksionet për profesionin e shëndetit; me këtë rast **Dr. Katalin Pirkhoffer Seresné**, zafir menaxhere flet për ruajtjen e shëndetit gjatë verës. Tema është aq komplekse, analiza aq e detajuar, sa që do të ishte e vështirë të jepje më shumë në një leksion të ngjeshur. Doktoresha na rreshton faktorët e dëmshëm që ndeshim në stinën e verës , pastaj na bën të njohur dritën e diellit, shkaktarët e sëmundjeve, natyrën e problemeve që shkaktojnë alergji dhe dëmtime të ndryshme. Sikurse thotë ajo, për shkak të ndryshimit të mjedisit të kohës moderne, këto fenomene paraqiten në shkallë më të madhe. Por kundër tyre kemi armët tona: në radhë të parë lëkura jonë me funksionet e saja mbrojtëse dhe natyrisht sistemi ynë i imunitetit. Por për mbështetjen e këtyre duhet që trupin ta ushqejmë dhe trajtojmë; dhe për këtë na ofron mjetet e shkëlqyera, bimët medicinale të natyrës me paletën e vitaminave dhe lëndëve minerale.



Leksiku i FLP

Soaring Menaxher:

Arrin Soaring Menaxher ai distributor që punon në nivelin e Menaxherit dhe në linjën poshtë tij punojnë 5 menaxherë të gjeneratës së parë të sponsorizuar. Arritjen e nivelit të Soaring Menaxherit FLP e vlerëson me distiktivin me 4 gurë të çmuar.



Pas asaj vazhdon prezantimi praktik i Drejtorit rajonal të Debrecenit, **Kálmán Pósa**, për të na njohur me faqen e re të internetit për distributorët, që mund të shihet në faqen e internetit të Qendrës të FLP në adresën: www.foreverliving.com. Në ekran ndjekim rrugën e një rrjetndërtuesi që nga faqja e hapjes deri tek faqet e tjera. Para nesh shpaloset një zyrë virtuale e mirë organizuar. Njeriu vetëm regjistron numerin kodik të distributorit, dhe pastaj programi punon si një sekretar personal. Na tregon çdo hap që duhet të bëjmë, mund të shikojmë rezultatet tona, formimin e pikëve, marrim raporte, mund të shikojmë linjën e poshtëme, mund të shikojmë dhe sa pikë na duhen për nivelin e ardhshëm. Mund të shfrytëzojmë përdorimin e My FLPBiz, mund të shikojmë raportet e televizionit të FLP. – „Ky është një mjet që nuk bën punën tonë, por mund të jetë një ndihmë e madhe në punën tonë” – thekson Kálmán Pósa.

Pika kulminante e ditës vazhdon me ata që nuk kanë shumë kohë që kanë filluar ndërtimin e rrjeteve: kualifikimi i supervisorëve dhe asistent menaxherëve, kolegët dhe miqtë e tyre i duartrokasin ata para podiumit.

Menaxheri **Endre Kurucz** tashmë është ngjitur një shkallë më lartë „në shkallët e suksesit”, por nuk e ka harruar kur fitonte bukën si teknik elektrik. Tashmë pas disa vitesh ngjitet në podiumin e Foreverit si rrjetndërtues rezultativ. „Me specialitetin që kisha nuk mundja të fitoja qaq, krahasuar me punën që bëja – kujton ai, pastaj njoha këtë mundësi, fillova sipërmarrjen dhe pas shtatë muajsh në llogarinë time erdhi një shumë me shtatë shifra. Mezi e besoja dhe më tutje as që diskutohej më se ia vlen të të merreshe me këtë.”

Nga Endre marrim edhe një „Instruksion të shpejtë” : që sipas tij, është e rëndësishme për suksesin e një fillestari. „Të jesh 100% përdorues i produkteve (kjo do të thotë që çdo produkt që vjen në Forever ta provosh), dhe çdo muaj plotëso 4 pikëshin. Të jesh lojtar me skuadër, të shfrytëzosh sistemin, ndihmën e sponsorit dhe merr pjesë në takimet e organizuara. Kundër justifikimit prodho sfidën!”

Si një surprizë e këndshme , tani në skenë nuk ngjiten drejtuesit e programit por anëtarit më i vogël i familjes Nagy-Belényi: **Sonja** shtatë vjeçe kërcen. Elegante, plot talent, me kujdesin befasues të një vajze të vogël. Sot është dita e fëmijve: edhe **Szilárd Kúthi** ka tre filiza. Ai ka ardhur nga fushë tjetër. Para se të fillonte si rrjetndërtues ai ka punuar si shitës makinash. Në Forever nuk ka shumë kohë që arriti senior menaxher... Me këtë rast, ai na fton në Holiday Rally, por këtë duhet ta bëjnë shumë. Në çdo vit për këtë program (me dy ditë trainimi intensiv në bregdetin dalmat) ka dy periudha kualifikimi, që këtë avantazh ta përfitojnë ata më të përkushtuarit. Nga kjo Ditë Suksesi, për periudhën e dytë mbeten edhe 6 javë, kështu që Szilárd nxit gjithkënd që të ngjitet një shkallë marketingu më lart





dhe ndërkohë ruani qënien aktiv. Kur revista jonë do të botohet, nuk e dimë vallë kush do ta ketë shansin të shkojë në Porecs. Szilárd për herë të parë mundi të bëhej pjesë e këtyre përshtypjeve në vitin 2008, dhe thotë se kjo gjë ka një efekt fantastik. Në Porecs njeriu merr atë „shkëndijën“ që e ndihmon të formohet vërtetë.“ – thotë ai. Dhe vërtet me histori suksesi spektakolare kanë filluar në vitet e shkuara në Kroaci. Disa shembuj na i jep edhe Szilárd i cili thekson: „Atje edhe ajri është ndryshe“. Një udhëtim i tillë ndihmon edhe për atë që skuadrat të jenë më të lidhura. Ndërsa për të ardhmen nuk duhet të shqetësohemi: „Në qoftë se pseja jote është e fuqishme edhe mënyra se si ta realizosh vjen vetvetiu“ – pohon menaxheri.

Përsëri festojmë arritjet: janë kualifikimet e atyre me 60 pikë, kualifikimet e menaxherëve, menaxherëve drejtues, të kualifikuarit e programit të veturës, po kështu vlerësohen anëtarët e Klubit të Presidentit, pastaj vazhdon leksioni i menaxherit **József Mázás**.

József si teknik i industrisë të ndërtimit drejton një firmë që merret me zbatimin e përgjithshëm. U përket atyre anëtarëve të FLP, që megjithë nivelin e menaxherit nuk e kanë lënë punën e mëparshme. Për 8 javë u bë menaxher dhe jo shumë kohë më vonë edhe anëtar i Klubit të Conquistadorëve. Sikurse shprehet, jeta e tij që nga ajo kohë ka ndryshuar qindpërqind. Duhet menduar gjëra të mëdha. Ky është mesazhi në leksionin e tij të sotëm. „Firma është e përsosur, ne vetëm duhet të theksojmë modelet. Nga njëra anë duhet të zgjedhim njerëz të tillë, të cilët duam të na respektojnë, nga ana tjetër vetë duhet të jemi model.“ József na nxit që njerzve të marrim guximin tu tregojmë gjëra të mëdha; sipas tij ky është kredibiliteti më i rëndësishëm. „Atë që thua, vure në praktikë çdo ditë! Unë edhe në industrinë e ndërtimit mësoj nga më të mirët, ndërsa në hobin tim të sportit me qentë drejtpërsëdrejti nga kampionët gjermanë. Ka rëndësi që një drejtues të mund ta respektoj edhe si njeri, por edhe si një specialist të asaj fushe. Unë prej këtej tashmë nuk e kam të vështirë të ëndërroj gjëra të mëdha për të arritur objektivat e përbashkëta.“

Pas kualifikimit të asistent supervisorëve, Brigitta dhe Ádám, thërrasin në skenë „Motivuesin më të madh“ **Tibor Lapicz**, që mbyll serinë e leksioneve. Soaring menaxheri e fillon leksionin me një të dhënë: „Muajin që shkoi u regjistruan 800 vetë si asistent supervisorë. Pyetja shtrohet: sa nga këta janë të tutë dhe sa vetëve ua ke treguar mundësinë e FLP?“

Sipas Tibor, firma funksionon më mirë sot se më përpara: „Është më e madhe energjia e përqëndruar në të. Vijnë të rinj njëzet vjeçar me një hov të fuqishëm dhe duan ta bëjnë!“ Tibori na tregon se ka shumë, që këtë punë e shohin nga larg dhe e mendojnë si një detyrë të lehtë. Por sikurse nënvizon





lektori, ky është një profesion serioz, dhe duhet ta bësh me forca të mëdha që të funksionojë". Sipas tij për këtë ka mundësi të mira sepse, tregu është pastruar". „Këtu është rasti, që tash të sigurosh një të ardhme të sigurtë për veted he për familjen tënde. Vetëm se ti duhet të bëhesh menaxher që si të thuash të çosh çdo muaj në shtëpi brënda një kohe të shkurtër, një të ardhur 5 herë më të madhe se ajo e një të punësuar dhe ndërkohë të bësh një jetë të lirë. Për këtë nuk të duhet gjë tjetër veçse të kuptosh se si funksionon ky biznes, dhe pastaj sistemin e mardhënieve të tua prezantosh sa më shumë njerzve. Nuk duhet ta komplikoni, dhe kurrë mos besoni, vërtet mos besoni se është çështje fati!"

Për të mbështetur pikpamjen e tij e fillon me një eksperiment. Thërret 50 asistent supervizorë, të cilët marrin letrat e tyre. Tibori modelon prezantimet e biznesit, të cilat sipas statistikave, „filtrojnë” dëgjuesit. Domethënë do të ketë nga ata që do të dalin nga rrethi dhe do të thonë: Po. Ashtu si në lojën me letra, ku ato më të rëndësishmet dalin në radhë të parë, ashtu edhe bashkpunëtorët e mundshëm. Ndërsa dalin nga radhët 3-shat, 4-rat, etj, pastaj nënshkruajnë „mbretërit”, Asat dhe më në fund natyrshëm ndesh tek dy Xholat. Vetëm se duhet ndarë shumë letra!

„Por nuk do ti gjesh Xholat në qoftë se nuk i hap letrat, pra në qoftë se nuk zgjerohesh” – na jep si mesazh

Tibor, pastaj bie fjala edhe për një gjë tjetër, për vrullin, pa të cilin nuk mund të ketë rezultate.

Në podium ndodhet një copë dru, me të cilën nuk ndodh asgjë, deri sa sopata që soditet

nuk merr vrullin dhe në qoftë se Tibori nuk i bie me të këtij druri. Pra më kotë

kemi në dispozicion mjetet e FLP, nuk jemi të aftë për asgjë në qoftë

se ato nuk i përdorim për jetë, „Fati yt nuk është vulosur, atë mund

ta ndryshosh. Vetëm mos i ler të humbasin endërrat! Qëndrimi

yt e përcakton se kur do të kesh biznesin tënd. Jepi gjithkujt

mundësinë që të bëhet me vlerë si Xholi, por kurrë mos harro

që biznesi funksionon nga ti. Pra merr telefonin dhe fillo të

telefonosh! Ndrysho dimensionin! Dhe nuk do të kalojnë shumë

kohë, kur unë të jem ulur në vendin tënd dhe ti të jesh në

podium. Unë do të bëj tifozllëk për ty!"

Për Ditën e Suksesit
të ardhshme takohemi
më 15 Shtator! Deri
atëhere pushime të mbara
dhe ndërtim rrjetesh të
sukseshme!



ZLATIBOR

TAKIM I MENAXHERËVE

Tashmë është bërë traditë, që në qershor menaxherët më të sukseshëm të FLP të Serbisë të takohen në qëndrën e mrekullueshme turistike të Zlatiborit që gjendet në prehrin e maleve, me qëllim që ti vënë objektiva të reja vetes dhe të mbushen me energji që e domosdoshme për këtë punë.

Sivjet ky takim u zhvillua në mënyrë krijuese ku çdo menaxher të marrë pjesë në mënyrë aktive. Gjatë dy ditëve të kaluara në Zlatibor dhe në Tornik, mundëm të mësonim shumë, të shkëmbejmë përvojën me sponsorat, të pyesnim dhe të na pyesnin, ndërkohë të sistemonim mendimet dhe të caktonim rrugën që duhet ndjekur.

Falnderojmë gjithashtu, diamant menaxherët Veronika dhe Stevan Lomjanski, të cilët me këshillat e tyre dhe gjatë përpunimit të temave, qenë një ndihmë e madhe për ne.

Por të shohim për çfarë temash u bë fjalë: shikimi i mundësive, vlerësim dhe zhvillim i mëtejshëm, analiza e situatës aktuale dhe caktimi i objektivave, caktimi i drejtimeve të duhura të realizimit të këtyre objektivave, bisedë për rëndësinë e ndërtimit të skuadrës dhe për punën në grup, përforsimi i nivelit të menaxherit me realizimin e 60 pikëve jo-menaxheriale, njohje e detajuar e programit Profit Sharing, mënyrat e njohjes të bashkpunëtorëve të rinj, mundësitë e bashkpunëtorëve sipërmarrës privatë, interneti si mjet i zgjerimit të punës...Dhe dy ditë kaluan si një çast i vetëm!

Jemi në harkun e ngjitjes, prandaj duhet ti shfrytëzojmë potencialet tona. Realizimi i vetvetes nëpërmjet punës: kjo do të thotë që përsëri duhet të jemi më të mirët. Duhet të gjallërojmë aktivitetin tonë sidomos kur e ndiejmë që njerzit që na rrethojnë duan të bashkpusojnë me ne. Një menaxher i pjekur objektivat e tij ia nënshton objektivave të skuadrës së tij, sepse vetëm kështu mund të ndërtohet një rrjet rezultativ.

Fryma e skuadrës dhe energjia, që rrezaton skuadra „Diamond Team” e Serbisë, njihet larg në botën e Foreverit. Kjo frymë skuadre i tërheq bashkpunëtorët tanë në çdo takim të FLP.





E kemi parë se kur në mes të rritjes më të madhe, shfrytëzojmë në mënyrë aktive burimet tona të forcës, atëherë lulzon më shumë biznesi ynë! Përgjigjet krijuese fshihen tek ne, dhe duhet të tregojmë edhe shembullin personal.

Nuk jemi vetëm sponsor por edhe mentor, që duhet tu tregojmë rrugën bashkpunëtorëve të rinj, që edhe ata ti shfrytëzojnë burimet e tyre të forcës. **FRYMËZIM** – sa bukur tingëllon kjo fjalë, megjithse herë herë duket e largët.

Që ti mbash bashkpunëtorët e rinj do të thotë që tek ata të ushqejmë bindjen në forcat e veta dhe besimin tek sukcesi.

Zogjtë e shqiponjës të FLP të Serbisë, takimin e tyre dy ditor e perfunduan në lartësinë 1500 metra ku u mrekulluan me panoramën e qëndrës të skive në Tornik. detyrat kreative ishin shumë interesante, po kështu edhe leksionet, ndërsa pjesmarrësit u pasuruan me njohuri dhe energji të reja.

Shpresojmë që ato që u theksuan këtu të nxitin për përpjekje të mëtejshme dhe shembulli personal të jetë i dobishëm për skuadrën dhe kështu në të ardhshmen të takohemi me më shumë menaxherë të sukseshëm dhe të kënaqur!

Barnislav Rajić
Drejtor Rajonal
i Forever Living Products Serbi



DITË SUKSESI TROPIKE NË BEOGRAD. FALENDEROJMË TË GJITHË ATA, QË NË VEND TË PISHINAVE ZGJODHËN DITËN E SUKSESIT NË BEOGRAD!

SUCCESS DAY

BEOGRAD,, 1.07.2012



Drejtuesit e takimit ishin **Mara dhe Boro Ostojić**. Forever-i i bashkoi ata për jetë, ju dha atyre martesën, shëndetin, jetën e qetë familjare, si dhe mundësinë, që mesazhin e Forever-it të mund ta ndajnë me miqtë. Ndonëse jemi në mes të verës, prapë nuk jemi të qetë. Shumë gjëra kanë ndodhur në javët e fundit, po afron fundi i periudhës për kualifikimin në Holiday Rally, më pas do të vijnë edhe programet e tjera stimuluese. Drejtori rajonal i FLP-s për Serbinë, **Branislav Rajić** përmbledhi shkurtimisht parimet drejtuese që lidhen me verën. N.q.s. nuk do të kishte suksese dhe dështime, dhe jeta do të vazhdonte në mënyrë monotone, atëherë do të rezultonte në pasivitet dhe pakënaqsi të thellë – theksoi drejtori Rajić.

Falenderojmë drejtorin e përgjithshëm të FLP-s, **Dr. Sándor Milez** për përkrahjen dhe letrën përshëndetëse. Njerëzit prej nesh besojnë në Forever, bashkë me të shikojnë punën e tyre, si dhe drejtuesit e fatit të tyre, e cila bazohet në FLP-n.

Duke ndjekur leksionin e hollësishëm të **Uglješa Nikolić** me profesionin e parukieres, të njohurve tanë ju zgjerua paleta në fushën e kujdesit të flokëve. Produktet bio të FLP-s, me bazë bimët mjeksore, me koncentrim të lartë të lëndëve përbërëse aktive, në rradhë të parë janë mjete për kujdesin e flokëve. Është kjo që na ngre ne nga firmat e tjera të ngjashme prodhuese.

Ngarkesa psikike dhe stresi përfaqëson realitetin e trishtuar të përditshëm. Si mund të ndihmojmë në këtë? Forever Living Products-i na jep të gjitha mjetet, që ti zhdukim efektet negative të jetës moderne - thekson **Dr. Rozmaring Mirkov**.

Efektet mirëbërëse të produkteve i kanë provuar jo vetëm distributorët, por edhe mjekët, të cilët kanë gjetur një pikë takimi mes profesionit të tyre dhe cilësisë së produkteve. Dëgjuam histori të besueshme dhe të sinqerta nga ata njerëz, jeta e të cilëve u bë më e



bukur, pasi filluan të përdorin produkte ndonëse të një niveli botëror, por që janë të arritshme për këdo. Falenderojmë prezantimin e **Dr. Bora Vijasinak**. Në skenën e Shtëpisë së Sindikatave falenderuam supervisorët dhe asistent menaxherët e rinj, të cilët deri në arritjen e nivelit tjetër të planit marketing i pret një sfidë e madhe.

Dragoljub **Mičko Ljubičić** është specialist i çështjeve intime. Në mënyrë interesante dhe humoristike, tregon situata të përditshme nga burrat dhe gratë, të cilat secili prej nesh i ka kaluar tashmë.

Menaxheri **Jasna Hrnjčar** leksionin e filloi me një pyetje: A ka midis të pranishmëve nga ata që luftojnë me problemet? „Nëse besoni, që ekzistojnë njerëz pa probleme, gaboheni shumë! Karriera ime filloi me të vërtet ngadalë, por mbas marrjes së vendimit e arrita nivelin e menaxherit, falë sponsorëve të mi. Në një firmë të tillë vetëm sipërmarrësit që ndërmarrin një aventurë arrijnë suksese, sepse çdo sukses ka çmimin e vet. Në atë moment, kur entuziazmi fiton mbi fenomenet frenuese të jashtme, karriera juaj në FLP do të shndrohet në transmesion rakete.“

Kualifikimi i menaxherëve të rinj ishte çasti më i bukur në gjithë Ditën e Suksesit. Fytyra të kënaqura, të sinqerta, buzëqeshje të mëdha, grupe bashkpuntorësh, të cilët i lidh bashkë besimi, puna dhe përkujdesja. Urime menaxherëve të rinj!



Bashkpunorët më të suksesshëm i përmbledh plus 60cc dhe Klubi i Sundimtarëve. Nuk ka vende të marra me qira, të gjithë i pret shoqëria e më të mirëve!

Si rezultat i një vazhdimësie të gjatë guri shndërrohet në diamant – kjo është edhe një nga pikat kulmore të punës tonë. Ne nuk na intereson, se si nuk është e mundur, por ajo, se si mund të realizohet! Jo për të gjithë vlejnë të njëjtat mënyra, duhet t'jua përshtatim antarëve të grupit me ato ndryshime, për të ndërtuar së bashku karrierën tonë në FLP – na bën të ditur **Jordan Aleksov** - senior menaxher. Të falimentosh në punë është diçka njerëzore, të mbetesh i shtrirë është çështje djalli, por të ngrihesh e të fluturosh përsëri është diçka ëngjëllore!



Për disa nga bashkpunorët tanë niveli i asistent supervizorit është hapi më i rëndësishëm. Kjo është shkalla e parë por më e rëndësishmja në planin marketing të Forever-it. Ju urojmë me sinqeritet të gjithë asistent supervizorëve të rinj shumë sukses në punën e tyre të mëtejshme!

Qëllimi ynë i vendosur është, që të mos kthehemi mbrapsht përballë vështirësive dhe pengesave, kjo të çon drejt suksesit. Vendosmëria i hap të gjitha dyert. Një person i vendosur vepron me maturi përball çdo pengese, përdor strategji të mira, që të kapërcej vështirësit.

Dr. Marija Ratković - zafir menaxhere është një nga personat më të besueshëm në FLP, që të flasë si për vendosmërin ashtu edhe për zgjidhjen e problemit. Dëshira e saj personale është çelsi i suksesit i të gjithë grupit, pikërisht vetbesimi është ajo shenjë personaliteti, që i dallon njerëzit e suksesshëm nga të zakonshmit. Falenderojmë leksionin interesant si edhe punën e bashkpunorëve të tjerë.

Takimi tjetër i radhës do të mbahet në 23 shtator në Shtëpinë e Sindikatave

Branislav Rajić
Drejtori rajonal i Forever Living të Serbis



SOARING MANAGER SZINTET ÉRT EL



Sonja Jurović & Zlatko Jurović
(sponsor: *Tibomir Stilin & Maja Stilin*)

"Kemi një punë të tillë, ku nuk ka nevojë të punojmë, por ku duhet të jetojmë realizimin e endërrave tona. Përveç fëmijve dhe nipërve, Foreveri është pjesa më e rëndësishme e jetës sonë"



NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITI



Csontos Sándorné
(sponsor: *Angéla Csontos*)

„Parimi themelor më i rëndësishëm i suksesit tonë personal dhe të biznesit thjesht tingëllon kështu: bëhemi të asaj, për të cilën mendojmë më shumë”



Petra Smiljanić & Marko Smiljanić
(Sponsor: *Sedina Kovač*)
„Kurrë mos u merr me atë, sa punë të pret dhe sa e pamundshme të duket sfida. Mbaro atë që ke filluar, dhe pastaj hidh hapin tjetër!”

Andrea Nagy
(sponsor: *Ágnes Vass-Filipov & Gábor Filipov*)

„Në qoftë se ke objektiva të forta, do të vijë edhe zgjidhja! Rezisto, ti je çelësi i suksesit tënd!”



Boris Vlastelić & Nikica Vlastelić
(Sponsor: *Sonja Jurović & Zlatko Jurović*)

„Për ne është kënaqsi, që u bëmë anëtarë të familjes Forever që popullarizon mënyrën e jetës së shëndetshme dhe pavarësinë financiare”



Predrag Živković & Svetlana Živković
(sponsor: *Željko Nikolić & Jelena Ivanović*)
„Mos kërko justifikime, por zgjidhje. Shfrytëzoje çdo ditë, ec më përpara në rrugën që të çon në realizimin e endërrave të tua. Dhe atëhere nuk ekziston më e pamundura.”



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Bartus László & Bartusné Czalbert Márta
Milica Cvetković
Milan Komatović & Vesna Komatović
Vitomir Nešić & Suzana Radić

Csordás Sebastian
Ana Djuriček & Jan Djuriček
Dr. Barta Béla Barna & Dr. Barta Béla Barnáné
Dr. Melanija Ilić & Bogdan Ilić
Dr. Kneisz Éva
Fiser-Besenyei Noémi & Fiser Péter
Marija Greksa & Jan Greksa
Rudolf Grubišić & Mirjana Grubišić
Martina Grubišić & Goran Brnelić
Hanzl Márk
Jurić Robert
Kádas Krisztina
Koncz Béláné & Koncz Béla
Krasznyánik Natália
Magonyné Sódar Ildikó & Magony István
Magyar Sándor & Magyarné Szabó Szilvia

Majoros Csaba
Nela Makšić & Aleksandar Makšić
Borislav Matić & Milica Matić
Novák László & Novák Lászlóné
Pauer Edit
Pintér Aladárné
Pintér Attila
Piskor Zoltán
Mija Purgaj & Markl Matić
Szépné Langer Ágnes & Szép Lajos
Szabóné Török Krisztina & Szabó Antal
Szigeti László
Szolivajs Katalin & Dr. Hagymásy Lászó
Lovro Tomović
Wind Ágnes
Mira Živković



NIVELIN E SUPERVISOR-IT E ARRITËN

Bischofné Papp Éva & Bischof Csaba
Bittó Józsefné
Bittó Zoltán & Bende Viktória
Boza Anikó



BASHKË NË RRUGËN E SUKSESIT



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1

Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter
Becz Zoltán & Kenesei Zsuzsanna Viktória
Bruckner András & Dr. Samu Terézia
Marija Buruš & Boško Buruš
Dr. Dósa Nikolett
Éliás Tibor
Olivia Gajdo
Gecse Andrea
Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
Gyurik Erzsébet & Sándor József
Hajcsik Tünde & Láng András
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Hertelendy Klára
Illyés Ilona
Rinalda Iskra & Lučano Iskra
Dragana Janović & Miloš Janović
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Sonja Jurović & Zlatko Jurović
Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
Klaj Ágnes
Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
Kúthi Szilárd
Lapicz Tibor & Lapiczné Lenkó Orsolya

Lipp Szilvia & Molnár Mihály
Dr. Molnár László
& Dr. Molnár-Stantić Branka
Muladi Annamária
Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta
Vaselije Njegovanović
Dr. Pavkovic Mária
Dr. Marija Ratković
Dr. Rokonay Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Sebők Judit
Senk Hajnalka
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Sulyok László & Sulyokné Kökény Tünde
Dr. Surányi Katalin & Gazdig Sándor
Dr. Szénai László
& Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Szöllösi Cecília
Tanács Erika
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Varga Józsefné
Visnovszky Ramóna & Bognár Gábor
Jozefa Zore

Zsidai Renáta

NIVELI 2

Haim Józsefné & Haim József
Kása István & Kása Istvánné
Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
Orosházi Diána
Siklósné Dr. Révész Edit & Siklós Zoltán
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Utasi István & Utasi Anita

NIVELI 3

Berkics Miklós
Tomislav Brumec & Andreja Brumec
Budai Tamás & Budai-Schwarcz Éva
Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
Halmi István & Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Krizsó Ágnes
Leveleki Zsolt & Leveleki Anita
Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski
Szabó József & Szabó Józsefné
Tóth Sándor & Vanya Edina
Vágási Aranka & Kovács András
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea

CONQUISTADOR CLUB

06. 2012. DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM NË BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT



HUNGARIA



1. Németh Antal & Németh Antalné
2. Nagy Andrea
3. Franyó Anna
4. Bartus László & Bartusné Czalbort Márta
5. Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
6. Csontos Sándorné
7. Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
8. Lapicz Tibor & Lapiczné Lenkó Orsolya
9. Klaj Ágnes
10. Dr. Szénai László & Dr. Szénainé Kovács Gabriella



KROACIA



1. Jurović Sonja & Jurović Zlatko
2. Vlastelić Boris & Vlastelić Nikica
3. Kraljić-Pavletić Jadranka & Pavletić Nenad



SERBIA



1. Paligorić Stojanka & Paligorić Aleksandar



SLLOVENIA



1. Smiljanić Petra & Smiljanić Marko
2. Cvijanović Ana & Cvijanović Božidar



TOP SECRET

Pjesa kryesore e kësaj historie filloi në vjeshtën e 2010, kur mu mbaruan disa plotësues dietikë, të cilat i kam përdorur sistematikisht gjatë 10 viteve. Kërkova dikë që punon në FLP, kështu takova zonjën Rinalda Iskra, pa menduar se ku do të çojë ky takim me një premtim të zakonshëm. Kur Rinalda solli produktet u binda se në fakt ne e njihnim njera tjetrën, në fakt nga larg, mbasi kishim punuar diku po në të njëjtën fabrikë. Duke pirë kafe Rinalda më sqaroi se si mund ti marr këto produkte me çmim më të lirë. Pastaj më skicoi edhe mundësitë për biznes. Migjithatë në atë kohë brënda vetes kisha një pengesë, skepticizmin, „një lloj” rezistence ndaj këtij biznesi. Rinalda më këshilloi të mos nxitohesha në përgjigjen, por ta mendoja atë. Për këtë punë nuk ka nevojë për ndonjë njohuri të fillimit apo për arritjen e ndonjë rangui. Kushdo e fillon një lloj, thjeshtë me nënshkrimin e një formulari regjistrimi.

Brënda vetes më filluan pyetjet: si do ta zgjeroj rrjetin në këtë fshat me numer popullsie të vogël? Sa kohë do të më duhet për përvetsimin e materialeve njohës. Si do ti prezantoj produktet që nuk i kam provuar vetë? Por Rinalda për të gjitha këto kishte një përgjigje: mos u shqetëso para kohe! Në qoftë se do vërtet të punosh unë do të jem pranë teje, sa të bëhesh e pavarur. Kjo është punë në grup, nuk je vetëm, çdo gjë do ta zgjidhim së bashku! Duke marrë guxim nga këto fjalë, duke u mbushur me vetëbesim, mora përsipër sfidën, dhe me këtë pranovë edhe si sponsor Rinaldan. Mbasi u largova për shkak të shkurtimit të personelit, rruga e re mu duk si një zgjidhje e pranueshme.

Kështu më 16.11.2010 bëra porosinë e parë. Falë këshillave të sponsorit tim me përvojë, brënda Dhjetorit arrita nivelin e Supervisorit. Lista emërore zgjerohej gjithnjë e më tepër, gjithnjë e më tepër bëja prezantime, dhe prilli 2011 më solli nivelin e asistent menaxherit. pas kësaj në bazë të një plani të përpunuar me kujdes, duke dashur të shijoja suksesin, me skuadrën time të etur për sukses u nisa drejt nivelit të menaxherit. Ishin ditë të pabesueshme, plot me frymëzim, me adrenalinë, me shpresa por edhe me punë të investuar. Më në fund erdhi dhe rezultati. Pa ndihmën e sponsores time Rinalda dhe pa ndihmën e bashkpunëtorëve nuk do të ishte arritur gjith ky rezultat.

Më 30.6.2011 Tanja dhe Egon Knežević u kualifikuan supervisorë, Vesna dhe Ado Đelmo u bënë asistent menaxherë, kurse unë dhe im shoq Radoš u kualifikuam menaxherë, ndërsa Rinalda me bashkëshortin Lučijano plotësuan kërkesat e programit stimulues të veturës. Për një kohë nuk e kisha kuptuar rëndësinë e punës që kisha bërë. Tani e di se titulli i menaxherit nuk është stacioni i fundit, kjo është vetëm një pjesë e mirë e punës që na pret. Perspektiva të reja na hapen. Por ka rëndësi të duam dhe të kërkojmë të dalim nga sforcimi i përditshëm, dhe gjatë jetës të merremi me atë që duam ta bëjmë dhe jo me atë që na detyron rutina e përditshme. Edhe një herë falnderoj nga zemra sponsorin tim Rinalda për durimin dhe mbështetjen që më ka dhënë si dhe bashkpunëtorët e mi për zellin e tyre. Ju Ju uroj atyre, që edhe puna e bërë prej tyre të fitojë shpërblimin e merituar.



Irena dhe Radoš Sušanj
Menaxherë

FAB

BLEJ 4 PAKO FAB
DHE JU JAPIM DHURATË
PAKON E 5-TË!



*Endani edhe me të tjerët
këtë produkt fantastik!*



TOP 40

Plus kësaj 40 blerësit më të
mëdhenj „TOP 40” do të shpërblehen
në Ditën e Suksesit!



TË DASHUR DISTRIBUTORË

Ju njoftojmë me kënaqësi se nga 1 Shtatori 2012 përlogaritja e bonusit tuaj vjen tek ju në formë elektronike përmes faqes të distributorit www.foreverliving.com

Me këtë do të donim të bashkoheshim në ndërgjegjësimin për mjedisin e marrë përsipër nga Qendra në Amerikë, mbasi përdorimi i sa më pak letre pakëson ndikimin tonë mbi mjedisin. A e dini për shembull, që 10 000 pemë çlirojnë 150 milion litra ajër të pastër? A e dini që në Hungari prodhimi i mbeturinave të letrës arrin në 81 kg për frymë, ku për prodhimin e kësaj sasive duhen 178 kg dru dhe 2975 litra ujë si dhe ka nevojë për një sasi të madhe energjije (648 kilowatorë)? E në qoftë se këto të dhëna i shumzojmë për 10 milion të popullsisë hungareze do të na dalin shifra marramendëse. Pra do të kërkonim mirëkuptimin tuaj dhe që këtë ta bëni bashkë me ne për të ardhmen e Globit dhe të fëmijve tanë.

ÇFARË DUHET DITUR LIDHUR ME LLOGARINË ELEKTRONIKE TË BONUSIT:

Llogarinë elektronike të bonusit mund ta gjeni në faqen e re të distributorit në adresën www.foreverliving.com, në menunë „**Biznesi im**” në pikën „**Llogaria e bonusit tim**”. Fajlat që gjenden këtu në formatin PDF mund të ruhen (shkarkohen) në kompjuterin tuaj (kështu nuk humbet asnjë llogari të bonusit për njerin apo tjetrin shkak), ose mund të printojmë faqet e zakonshme (printimi në dy faqet kursen jo vetëm letrën por edhe ndihmon edhe ruajtjen e mjedisit). Sigurisht e kemi të qartë që jo gjithkush ka mundësinë e internetit. Prandaj që nga Shtatori, në çdo qendër të FLP në kompiuterat e saj gjithkush mund të printojë llogarinë e bonusit të vet.

Distributorët e rinj, në ditët pas regjistrimit të tyre mund të kërkojnë passwordin e tyre me një E-mail dërguar në adresën it@flpseeu.hu, dhe kështu në fillim të muajit pasardhës mund të shikojnë pa pengesë llogaritë e bonusit të tyre. Ka rëndësi që kërkuesi i passwordit në E-mail të jap të paktën 3 të dhëna (psh emrin, adresën dhe kodin e tij), në bazë të të cilave punonjësit tanë të informatikës të mund të sigurohen që passwordi i dërgohet personit përkatës.

Do të donim tju kujtonim se në faqen e distributorit do të gjenden vetëm ato llogari bonusi që nuk janë dërguar më parë me postë. Në përgjithësi llogaritë elektronike të bonusit mund të gjenden në faqen e vet distributorit mbas datës 10 të çdo muaji, duke arritur kështu shumë më shpejt se sa llogaria e bonusit të dërguar në rrugë postare, ku shpesh për shkak ndryshimi të adresës apo adresës të pa saktë nuk arrijnë tek ju. Shpresojmë që bashkë me faqen e re të distributorit edhe llogaria elektronike e bonusit të fitojë pëlqimin tuaj. Ju urojmë shumë suksese në punën tuaj!

Me respekt,
Drejtorja e FLP Hungari

KËRKESA PËR PASSWORDIN NË FAQEN E DISTRIBUTORIT:

Dërgoni një E-mail në adresën it@flpseeu.hu, ku të jepni emrin, adresën, numerin kodik të distributorit, ndërsa ne në letrën e pergjigjes ju dërgojmë passwordin e nevojshëm që llogaria juaj e bonusit të shfaqet në faqen tuaj të distributorit!



FOREVER TV I RINOVUAR

Kemi planifikuar krijimin e një kanali televiziv të ri, më i rinovuar dhe interaktiv. Urojmë ta zbukurojmë këtë program të rinovuar të televizionit Forever me një strukturë plotësisht të re, me një fytyrë të përtërirë dhe me programe ditore të reja dhe të larmishme. Ndërtimin e projekt programit të ri është bërë sipas nevojave dhe kërkesave të sotme, që sipas ideimit tonë mund të shfrytëzohet shumë në realizimin e objektivave të vëna. Do të dëshironim një strukturë programi të larmishëm, me programe që i kënaqin të gjitha moshat, me leksione motivuese, me filma portret, për të krijuar një televizion interneti të larmishëm, me një magazinë programesh, që mund të jenë shumë të dobishme për distributorët e rinj dhe bashkpunëtorët ekzistues. Për këtë do të kërkonim edhe ndihmën e rrjetndërtuesve.

Dërgoni mendimet tuaja, dhe çdo ide do ta presim me gjithë zemër.

Presim edhe paraqitjen e atyre bashkpunëtorëve që kanë punuar aktivisht në këtë televizion!

János Sztana Drejtues i prodhimit
Regjizor i FLP TV Sándor Berkes
Tel.: 70 436 4213 e-mail: flptv@flpseeu.hu

60CG+

TË KUALIFIKUARIT 06. 2012.

Jurović Sonja & Jurović Zlatko
Németh Antal & Németh Antalné
Nagy Andrea
Franyó Anna
Vlastelić Boris & Vastelić Nikica
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Kraljić-Pavletić Jadranka & Pavletić Nenad
Smiljanić Petra & Smiljanić Marko
Éliás Tibor
Csonotos Sándorné
Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
Lapicz Tibor & Lapiczné Lenkó Orsolya
Klaj Ágnes
Brumec Tomislav & Brumec Andreja
Paligorić Stojanka & Paligorić Aleksander
Szolnoki Mónika
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin & Dr. Seres Endre
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Vágási Aranka & Kovács András
Dr. Szénai László & Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Meggyesi Imre & Meggyesiné Kántor Tamara

PËRJETOJI AVANTAZHET QË OFRON FLP!

Plani ynë i marketingut ka përparësor motivimin; vetëm shpërblimi financiar nuk do mjaftonte për të mbajtur gjatë një grup distributorësh. Drejtuesit e mirë duhen ndihmuar edhe për atë që ta ndajnë veten bashkpunëtorë, pra ti vlerësosh ata. Menaxheri i mirë e ndjen se ndërtimi i skuadrës nuk qëndron vetëm në takimet, në pikët CC dhe në çeqet e bonuseve. Dihet se ky biznes ka edhe një anë më të thellë, një anë njerëzore, me këtë lidhen vlerësimi i tjetrit dhe mbajtja si shok: dy shtylla bazë të rritjes dhe stabilitetit të këtij biznesi.

Në qoftë se gjen kohë, që të shkëputesh nga rutina e përditshme, për ta kaluar mirë me njerzit kyç të skudrës tënde, patjetër që ia vlen s'inga pikpamja financiare ashtu edhe nga ana njerëzore. Vlera e një përshtypje të tillë i tejkalon shumë shpenzimet e bëra. Një nga arësytet pse kemi krijuar rrjetin e shtëpive të pushimit **Forever Resorts** është që tu japim mundësinë distributorëve tanë që ti „shijojnë ato” me një çmim shumë të favorshëm. A të ka vajtur në mendje të bësh një udhëtim 3-4 ditësh, me pak trainim, pak gjueti peshku, vizita turistike dhe pak sport ujor në një nga anijet-shtëpi të Foreverit, dhe se kjo është një nga mënyrat më të mira që të motivosh D dhe të përforcosh me ata mardhëniet e biznesit? Në qoftë se i ndani shpenzimet, për secilin mund të jetë e përbalueshme. Ndoshta disa ditë Resortat e Foreverit që gjenden në rrezë të malit **Grand Teton**, ndoshta është një shpërblim i madh për distributorët e tu që ngjitin shkallët në planin e marketingut. Mundësitë janë të mëdha, shpërblimet akoma edhe më të mëdha.

Shfrytëzoji avantazhet e sistemit të Resortave Forever! Prandaj janë krijuar që ti shfrytëzoni për zhvillimin e biznesit!

FOREVER  RESORTS

*„ndërtimi i biznesit
duhet
shijuar”*
Rex Maughan



vacation IN STYLE

ZBULONI AMERIKËN JUG-PERNDIMORE DHE PUSHONI PER QEJFI!



Një avantazh më i ri është ai që je distributor i FLP...
(anija mban 12 vetë, sille skuadrën tënde!)

NJË OFERTË VEÇANTË PË DISTRIBUTORËT AKTIVTË FLP:

**Në rast marrje me qira të anijes-shtëpi të Foreverit keni 25% ulje
Zgjidhni kohën e përshtatshme dhe kohëzgjatjen e pushimit!**

TELEFON: 1-800-255-5561

Referoju asaj që i përket familjes Forever dhe sinjalizo që do të doje të përfitoje Skonton e Distributorit të FLP
(Active FLP Distributor Discount)

ForeverHouseboats.com



KURDO

mund të përtërihesh”

ZSOLT FEKETE DHE NOÉMI RUSKÓ - ZAFÍR MENAXHERË

PO TA SHOHËSH VETËM NË SKENË ZSOLT FEKETE TË NGJALL PËRSHTYPJEN E NJË NJERIU ME URRA OPTIMISTE, DHE NUMERA CIRKU. POR KUR ËSHTË FJALA PËR PUNËN E PËRDITSHME, ZAFIR MENAXHERI KA NJË STRATEGJI SHUMË RACIONALE DHE BASHKË BASHKSHORTEN MENDOJNË PËR GJËRA TË MËDHA.

